



With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



KATEDRA JEAN MONNET

EEAABAC

EU ENLARGEMENT AND ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES

SHKOLLA VERORE

Legjislacioni dhe institucionet e BE-së për profesionistët e së ardhmes

11 KORRIK – 15 KORRIK 2023

E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE KUNDREJT LIRIVE DHE TË DREJTAVE
THEMELORE TË NJERIUT

Dr. Blendi Himçi

Departamenti i së Drejtës – UNIEL

*E DREJTA E PRONËSISË INTELEKTUALE KUNDREJT LIRIVE
DHE TË DREJTAVE THEMELORE TË NJERIUT*

- 1. Debati teorik mbi monopolin intelektual*
- 2. PI & Kultura e lirë*
- 3.PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane*
- 4. Praktika gjyqësore e GJED*
- 5. PI në të drejtën shqiptare*

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

- Baza e përbashkët: të shpërblehen krijuesit për krijimtarinë e tyre.
- Divergjencat: a është pronësia intelektuale mjeti i përshtatshëm?
- Kritika: Proteksionizëm i tepruar ndaj pronësisë intelektuale (PI).

- Sipas antropologes kanadeze *Rosemary Coombe**, pasojat e kontrollit monopolist në fushën e PI janë në dëm të diversitetit të shprehjeve artistike aq të nevojshme në një shoqëri demokratike.

- Ekonomistët argumentojnë se regjimi i PI mund të çojë në atë që njihet si tragjedia *anticommon*: përdorimi jo eficient i rezurseve për shkak të ekzagjerimit në njohjen dhe garantimin e të drejtave të pronësisë.

*<http://rcoombe.artmob.ca/wp-content/uploads/2011/10/BorderingDiversityandDesire.pdf>

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

Qasja mbi kuptimin e sendeve të përdorimit të përbashkët (commons):

- juridike
- ekonomike

*Yochai Benkler** - “commons” (informacion), lidhet me përbërësit e natyrës, si psh. uji, ajri, dielli, pyjet, liqenet etj.

-Qëllimi: mbrojtja e informacionit në të njëjtën formë me atë të ambjentit: nëse të mund të “përdorësh” lirisht ajrin do të thotë të marrësh frymë, atëherë akses i lirë në informacion do të thotë krijimtari, pra zhvillim i qënies njerëzore.

*<http://www.havenscenter.org/audio/yochai-benkler-freedom-power-networked-information-environment>

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

-Nga njëra anë gjejmë sloganin kundër *copyright* sipas të cilit “informacioni duhet të jetë i lirë”*.

-Nga ana tjetër kompanitë e mëdha të muzikës, software-ve etj. argumentojnë se “një botë pa PI do të ishte një botë pa ide”*.

*Boldrin M., & Levine D. K., *Against Intellectual Monopoly*, Cambridge University Press, USA 2008, fq. 5.

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

Copyright vs. Copyleft

- Nëse *copyright* përfaqëson për sistemin *Common Law* rëndësinë që kanë të drejtat pasurore për autorin e veprës, *copyleft* presupozon qarkullimin e lirë të veprave në internet dhe njohjen vetëm e të drejtave morale mbi veprat duke përjashtuar të drejtat pasurore mbi to.

-Dualizmi *copyright-copyleft* shmanget nga ekstremizmi i secilit pol nëpërmjet alternativës së tretë, të njohur si *creative commons* (**shih slide nr. 17**).

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

- Boldrin dhe Levine*: patentat, copyright, marrëveshjet kufizuese të licensimit apo forma të tjera të monopolizimit të krijimtarisë nuk janë mënyra e vetme dhe as më e mira për të shpërblyer krijuesit për punën e tyre.
- Ato krijojnë monopolizim të të drejtave (me kosto të lartë për shoqërinë) dhe si të tilla nuk arrijnë qëllimin e nxitjes së krijimtarisë. Përveç të drejtave të krijuesve të ideve duhet të garantohen gjithashtu edhe të drejtat e atyre që kanë përfituar në mënyrë të ligjshme një kopje të idesë, në formë direkte ose indirekte.

*Boldrin M., & Levine D. K., *Against Intellectual Monopoly*, Cambridge University Press, USA 2008, fq. 6-9.

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

- Si për patentat ashtu edhe për *copyright*-in ekzistojnë dy të drejta të autorëve të krijimtarisë intelektuale:

- a) e drejta për të shitur dhe për të blerë kopje të ideve të tyre (më saktë *ius utendi*);
- b) e drejta për të kontrolluar se si të tjerët i përdorin kopjet e tyre (më saktë *ius excludendi*).

Shtrohen pyetjet:

- a) Pse duhet që krijuesit të kenë të drejtën të kontrollojnë se si blerësit e përdorin një ide apo krijimtari?
- b) A janë përfitimet e shoqërisë nga monopoli intelektual më të larta sesa kostot e tij?
- c) Si garantohet mbrojtja e interesit publik?

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

-*Adam Smith* shpjegonte se pasojat e monopolit ishin ofrimi i më pak produkteve në shkëmbim të një cmimi më të lartë*.

- Për sa kohë flitet për muzikën kjo çështje nuk përbën problem madhor, por nëse i referohemi medikamenteve që janë të domososhme për të kuruar sëmundje të rënda për njerëzimin atëherë pasojat janë shumë të rënda për shoqërinë.

*<http://ecedweb.unomaha.edu/roas.pdf>

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

Le të analizojmë nga afër argumentimet e kundërshtuesve të monopolit intelektual*:

- së pari, vjedhja e një sendi sjell pamundësinë për ish-pronarin për të mund ta përdorur sendin. Në rastin konkret dupikimi i një file mp3 dhe shpërndarja e tij në rrjet nuk e sjell këtë pasojë, sepse në të njëjtën kohë persona të tjerë mund të vazhdojnë ta dëgjojnë muzikën pa u dëmtuar nga ky shkëmbim informacioni.

*Shih dhe artikullin online De Pace P, *Contro il monopolio intellettuale: il caso delle grandi major della musica*, në

<http://epistemes.org/2007/02/12/contro-il-PRONA DHE PRmonopolio-intellettuale-il-caso-delle-grandi-major-della-musica/>

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

- Nga ana tjetër blerja e një CD muzikore duhet t'i garantojë blerësit pronësinë mbi të dhe për pasojë edhe të drejtën për ta disponuar atë sipas dëshirës, me kusht që të mos shkelen të drejtat e të tretëve (sepse në këtë mënyrë mbrohet e drejta e autorit që të njihet nga të tjerët si krijuesi i veprës).
- Do të konsiderohej vjedhje në të kundërt, atribuimi ose shpërndarja e nje vepre muzikore nga ana e një personi që nuk është krijuesi i vërtetë i saj.

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

-Sipas Boldrin & Levine: nëse nuk konsiderohet i kundërligjshëm prodhimi i një fustani Armani për sa kohë atij nuk i vihet etiketa, pse nuk është e mundur të kryhet e njëjta gjë me CD muzikore?

*-Boldrin & Levine argumentojnë se kostot fillestare për prodhimin e veprës nuk janë të larta, por abuzohet nga vetë kompanitë për të reklamuar produktin
Pse ne radio degjohet disa herë në dita e njëjta muzikë për një periudhë të caktuar kohe?*

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

-Duke vënë në dispozicion të publikut vetëm një kategori të caktuar veprash muzikore (ato të cilat kanë mundur të përballojnë kostot e reklamimit!) dhe duke lënë jashtë të tjerat, dëmtohet vetë publiku, të cilit i mohohet e drejta për kulturë.

-Si konkluzion (sipas *Boldrine dhe Levine*): ligjet aktuale mbi *copyright* favorizojnë ekzistencën e një *oligopoli* në tregun muzikor botëror, dhe arritjen e përfitimeve të ekzagjeruara.

1. Debati teorik mbi monopolin intelektual

-Argumentimi i kritikëve ndaj monopolit intelektual mund të analizohet me shembuj:

-Psh. në sektorin e muzikës, kompanitë e mëdha (*major*) argumentojnë se shkëmbimi apo shkarkimi *on-line* nëpërmjet *software*-it P2P, i *file*-eve muzikorë të mbrojtura nga të drejtat e autorit konsiderohet i njëjtë me piraterinë informatike dhe vjedhjen.

2. PI & Kultura e lirë

- Literatura juidike debaton tashmë prej vitësh mbi kuptimin e nocionit të *kulturës së lirë (free culture)**.
- Ashtu sikundër tregu i lirë nuk do të thotë treg në të cilin cdo gjë merret falas, edhe kultura e lirë nuk nënkupton se mbi të nuk ka të drejta të pronësisë.
- Ajo nuk mund të jetë një kulturë në të cilën artistët nuk paguhen, sepse kjo do të ishte anarki, jo liri.

*<http://www.free-culture.cc/freeculture.pdf>

2. PI & Kultura e lirë

- Nevoja për ekuilibrim shprehet qartë në nenin 7 TRIPs dhe në Marrëveshjen WIPO mbi të drejtën e autorit, në të cilën parashikohet:

“[...] domosdoshmëria për të ruajtur një ekuilibër mes të drejtave të autorit dhe interesit më të gjerë publik, në vecanti për formim, kërkim dhe akses në informacion”.

Kërkohet ekuilibër mes interesave ekonomike dhe atyre sociale.

2. PI & Kultura e lirë

-Kufijtë e të drejtave të pronësisë mbi krijimet intelektuale nuk mund të jenë të mirëpërcaktuar, pasi flitet për kategori jomateriale.

-Kjo paqartësi sjell pasiguri në përcaktimin e së drejtës dhe të zbatimit të saj.

-Psh. për të lexuar një material nga internet duhet që më parë ta shkarkoj atë, pra të bëj një kopje: deri ku shtrihet në këtë rast e drejta e përdoruesit?

2. PI & Kultura e lirë

- E njëjta pikëpyetje shtrohet edhe në rastin e përdorimit të sistemit të *file sharing*. Sipas *Lessig*, e vetmja mënyrë që autorët të jenë të lirë të vendosin për përdorimin e veprave të tyre është nëpërmjet licensave *creative commons**.

*Shih *Lessig*, i cili propozon si zgjidhje të problemit përdorimin e licensave *creative commons*, në

<http://creativecommons.org/tag/lawrence-lessig>

2. PI & Kultura e lirë

Creative Commons

-Sipas teorisë se *Creative Commons*, mund të gjendet një ekuilibër mes të drejtës së autorit dhe përdorimit të lirë të veprës*.

- Vepra mund të vihet në dispozicion të publikut për përdorim të lirë ose të ruhen të drejtat e autorit mbi të, dhe njëkohësisht të garantohet përdorim i kufizuar për disa qëllime të caktuara ose kur plotësohen disa kushte të caktuara.

*<http://creativecommons.org/about>

2. PI & Kultura e lirë

Testi me tre grade ne te drejten e autorit (3 st)

Nga e drejta e autorit perjashtohen disa kategori.

-Testi me tre gradë përbën një mjet efikas për të parandaluar përdorimin e tepruar të përjashtimeve dhe kufizimeve nga e drejta e autorit në nivel ndërkombëtar*.

- Këto përjashtime dhe kufizime mund të gjejnë zbatim vetëm nëse plotësojnë njëkohësisht tre kritere:

- a) janë parashikuar për raste të caktuara të vecanta;
- b) nuk bien në kundërshtim me shfrytëzimin normal të veprës;
- c) nuk i sjellin dëm të pajustificuar titullarit të së drejtave.

* http://www.ivir.nl/publications/margoni/Diritto_2009_1.pdf, fq. 1-3.

2. PI & Kultura e lirë

Testi me tre grade ne te drejten e autorit (3 st)

- Testi me tre gradë është kritikuar për paqartësinë e tij.
 - Si do të interpretohen këto dispozita kaq të përgjithshme?
 - Cili është shfrytëzimi normal i veprës?
- Tendenca në vitet e fundit në eksperienacet e vendeve të ndryshme ka qenë drejt një interpretimi që ngushton ndjeshëm atë që njihet si përdorim i lirë i veprës (*public domain*).

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-Neni 27 (par. 2) - Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (D.U.D.Nj.)

-Neni 15 - Pakti Nderkombetar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (P.N.D.E.S.K.). Sipas kësaj dispozite:

1.Shtetet pale ne kete Pakt i njohin secilit (cdokujt)te drejten:

a) Të marre pjese ne jeten kulturore;

b) Te perfitoje nga progresi shkencor dhe nga aplikimet e tij;

c) Te perfitoje nga mbrojtja e interesave morale e materiale qe burojne nga çdo prodhim shkencor, letrar ose artistik autori i te cilit eshte ai vetë;

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-Lidhja që ekziston mes pronësisë intelektuale dhe të drejtave themelore të njeriut është reciproke: kërkohet një barazpeshim i së drejtës private që gëzon autori i një krijimtarie për mbrojtjen e saj dhe të drejtës së shoqërisë që të mund të përfitojë nga kjo krijimtari.

-Nëse i referohemi DUDNJ, fokusi duhet të përqëndrohet në tre drejtime: trajtimi i barabartë i shtetasve në gëzimin e të drejtave pa asnjë diskriminim; njohja e vlerave të traditës kulturore të popujve indigjene dhe të komuniteteve lokale që vjen si pasojë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale; shkencat dhe teknologjia.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

2.Masat qe Shtetet pale ne këtë Pakt do te marrin per te siguruar ushtrimin e plotë te kesaj te drejte duhet te perfshijne ate qe jane te nevojshme per te siguruar ruajtjen, zhvillimin dhe perhapjen e shkences dhe te kultures.

3.Shtetet pale ne këtë Pakt zotohen te respektojne lirine e domosdoshme per kerkimin shkencor dhe per veprimtarite krijuese.

4.Shtetet pale ne këtë Pakt njohin dobite qe duhet te vijne nga inkurajimi dhe zhvillimi I bashkepunimit dhe i kontakteve nderkombetare ne fushen e shkencës dhe te kultures.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-Në aktet e të drejtës ndërkombëtare vihet re një tendencë në kualifikimin e të drejtës së autorit nga e drejtë kulturore në të drejtë të pronësisë intëelektuale.

-Kështu në D.U.D.Nj. e drejta e pronësisë dhe e drejta e autorit si e drejte kulturore, parashikohen në dy dispozita (jo detyruese) të vecanta, respektivisht neni 17 dhe neni 27.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-E njëjta ndarje, po tashmë me karakter detyrues, u ruajt edhe në P.N.D.E.S.K.).

-Në tekstin origjinal të K.E.D.Nj. nuk parashikohet e drejta e pronës, e cila përfshihet në nenin 1 të Protokollin Shtesë (Nr. 1), sipas përkufizimit “cdo person fizik apo moral ka të drejtëqë të respektohen *të mirat* e tij”.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Cili është kuptimi i termit “të mira?”

-A mund të gëzojnë mbrojtje nga neni 1 Prot. 1 K.E.D.Nj. të drejtat e pronësisë intelektuale?

-Sipas Gj.E.D.Nj*. ky nocion ka një kuptim të pavarur nga ai i shteteve anëtare dhe përfshin *cdo interes që lind në marrëdhëniet ekonomike të një individi*, pra një interes që mund të vlerësohet ekonomikisht (përfshihen të drejtat e autorit të paktën në lidhje me të drejtat pasurore).

-Klasifikimin e të drejtave të autorit në familjen e të drejtave të pronësisë e gjejmë në nenin 17 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

**Gambino A. M., & Falce V., Scenari e prospettive del diritto d'autore, ed. ART. Roma, 2009, fq. 16-20.*

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-Një tjetër tendencë që vihet re në aktet ndërkombëtare, në lidhje me të drejtat e PI, është ajo e zgjerimit të kategorisë së të drejtave të PI të mbrojtura.

-Nga pikëpamja e subjekteve të mbrojtura, vihet re zgjerim i kategorisë, fillimisht «*autorët e veprave letrare, artistike dhe shkencore*» (në D.U.D.Nj. & P.N.D.E.S.K.), dhe më pas *mbrojtje e PI në tërësi*, duke përfshirë së fundi edhe titullarët e të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit (Marrëveshja e OBPI, TRIPs etj.)

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

- PI dhe të drejtat e njeriut duhet të mësojnë të jetojnë së bashku shprehet Torremans në librin e tij *Intellectual property and human rights*.

- Nga ana tjetër artikulli i Haugen *Pronësia Intelektuale: e drejtë apo privilegj?**, parashton çështjen e dallueshmërisë së të drejtave të PI me atë të të drejtave të njeriut, duke specifikuar se është e rëndësishme të mos ngatërrohen të dy konceptet.

*Haugen H. M. "The Journal of World Intellectual Property", Vol. 8, Issue 4, July 2005, fq. 445-458.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-Nga kjo konsideratë, shtrohet pyetja nëse të drejtat e PI mund të konsiderohen si të drejta të njeriut, ose nëse disa aspekte të të drejtave të PI mund të kenë statusin e të drejtave të njeriut?

-Komenti i Përgjithshëm nr. 17 mbi të drejtat e autorit bën një dallim mes të drejtave të PI-së standarte dhe mbrojtjes së garantuar nga neni 15 par. 1, gërma c) P.N.D.E.S.K.).

-Megjithatë nuk është i qartë kriteri që do të përdoret për të klasifikuar një krijimtari si kategori të të drejtave të njeriut apo jashtëtyre.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

- Nga ky koment rezultojnë me dy çështje çështje delikate që duhet të gjejnë zgjidhje në kuadrin e të drejtave të njeriut:

a) ajo e komuniteteve lokale dhe indigjene;

b) ajo e ekuilibrit mes të drejtave personale të autorit të krijimtarisë së veprës dhe të drejtave të tjera të njeriut të njohura nga Konventa.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

-Në vitin 2005 Komiteti mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore: *Komenti* i Përgjithshëm, i cili për herë të parë i dha kuptim par. 17 të Konventës*.

-Të drejtat që lindin nga krijimtaria intelektuale mund të jenë të drejta të zakonshme ose themelore (pra të përfshihen në kuadrin e të drejtave të njeriut).

-Një pjesë e ekspertëve të fushës argumentojne: “të drejtat e njeriut nuk mund të negociohen, ndërkohë që të drejtat e PI kanë karakter ekonomik”.

*http://sim.law.uu.nl/SIM/CaseLaw/Gen_Com.nsf/6a53968e2906c409c12568870055fbbe/4ed4ccda24ed2f11c12570cf0044d5ee?OpenDocument

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

- Një shembull konflikti mes të drejtave të autorit dhe të drejtave të njeriut vihet re në Konventën e Bernës e cila e kufizon mbrojtjen për një kategori të caktuar (që lidhet psh. me shtetësinë e autorit të veprës, me vendin e publikimit të veprës apo me parimin e reciprocitetit).
- Si mund të ekuilibrohen të drejtat e autorit me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut si psh. lirinë e shprehjes, të drejtën për shkollim (formim); ose e drejta për informim nga njëra anë dhe e drejta e privatësisë apo thyerja e konfidencialitetit nga ana tjetër?

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Të drejtat e PI dhe liria e shprehjes

Lidhur me Marrëveshjen TRIPs, në korrik të këtij viti, Parlamenti European në maxhorancë të ndjeshme refuzoi Marrëveshjen kundër falsifikimit (*ACTA- Anti-Counterfeiting Trade Agreement**):

- a) për mënyrën se si u mor vendimi mbi të (në mungesë të transparences dhe të procesit demokratik, pasi maarëveshjet kanë qenë të fshehta) e saj;
- b) për thelbin, për faktin se ACTA parashikon sanksione penale në rast shkelje të të drejtave.

**ACTA është firmosur në Tokyo në 26 janar 2012 nga 22 shtete anëtare të BE-së. Parlamenti European ka refuzuar të kryejë ratifikimin me 478 votë kundër, 39 pro dhe 165 abstenim.*

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Të drejtat e PI dhe liria e shprehjes

c) ACTA detyron Ofruesit e Shërbimeve të Internetit (*Internet Service Providers - ISP*) t'i ofrojnë titullarëve të të drejtave të dhënat personale të përdoruesve që shkelin normat ligjore mbi të drejtat e autorit (në këtë mënyrë i hapet rruga mekanizmve jashtë gjyqësorë për të verifikuar shkeljen dhe për të zbatuar sanksione).

- Sic vihet re qartësisht në këtë mënyrë preken liritë themelore të individit sic është liria e shprehjes, mendimit, privatësisë dhe ajo e procesit të drejtë.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

-Në nëntor të vitit 2001 u zhvillua në Doha - Katar, Konferenca e katërt e ministrave e WTO. Në lidhje me Marrëveshjen TRIPs, rezultati më i rëndësishëm lidhet me pranimin e kërkesës së vendeve në zhvillim për të përjashtuar mbrojtjen e patentave në rastet kur duhet mbrojtur shëndeti publik.

-Në mënyrë specifike, Marrëveshja TRIPs duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të mbështesë të dejtën e vendeve anëtare të WTO.

**Deklarata e DOHA-s & DOHA-s Waiver*

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

- Cështjet e trajtuara në Konferencën e Doha Waiver paraqesin për herë të parë një *dimension të ri të pronësisë intelektuale dhe të legjislacionit mbi konkurrencën, të lidhura këto ngushtësisht me të drejtat e njeriut (vecanërisht të drejtën për shëndet dhe të drejtën për të jetuar).*

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

PI & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

Përmes Deklaratës së Dohës (2001), anëtarët e WTO-së, pranuan se*:

- në raste emergjente (neni 5) qeveritë mund të lëshojnë licenca të detyrueshme për prodhimin e produkteve farmaceutike;
- shtetet të cilat nuk kanë kapacitet për prodhim, duhet të ndihmohen për sigurimin e produkteve farmaceutike (neni 6);
- shtetet zhvilluar duhet të ndihmojnë shtetet në zhvillim për sigurimin e transferimit të teknologjisë dhe njohurive në fushën e produkteve farmaceutike (neni 7).

*[http://www.etc-](http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETCHauptseite/manual/versionen/albanian/health/health.htm)

[graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETCHauptseite/manual/versionen/albanian/health/health.htm](http://www.etc-graz.at/typo3/fileadmin/user_upload/ETCHauptseite/manual/versionen/albanian/health/health.htm)

Dr. Blendi Himci - U.A.Xhuvani

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

-Teksti i nenit 12- të P.N.D.E.S.K. paraqet themelin e së dretës për shëndet.

Konventa të tjera rajonale të cilat e përcaktojnë më tej të drejtën për shëndet, janë:

- Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961 (neni 14), ndryshuar në vitin 1996;
- Protokoli Shtesë të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut në Fushën e të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e vitit 1988 (neni 10);
- Karta Afrikanë për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve e vitit 1981 (neni 16).

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

-Nëse i referohemi marrëveshjeve të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), impaktin më të lartë mbi shëndetin në fushën e PI-së e ka mbrojtja e patentave.

-Në fakt, patentimi i të mirave esenciale sic janë produktet farmaceutike dhe ato ushqimore në favor të subjekteve juridikë privatë është në kundërshtim me interesin publik.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

-Impakti negativ i Marrëveshjes TRIPs mbi disa të drejta themelore të njeriut sic janë e drejta për ushqim, e drejta e shëndetit dhe vetëvendosjes janë evidentuar disa herë nga organizmat ndërkombëtarë*.

- Ato kanë vënë theksin në prioritetin që duhet të kenë të drejtat themelore të njeriut ndaj politikave ekonomike.

-Sipas nenit 7 Trips, të drejtat e PI-së kanë një funksion social: ato duhet t'i shërbejnë interesit publik*.

* <http://dirittiumani.utet.it/dirittiumani/files/temi/pdf/1.pdf>, fq. 13-14.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

- Parlamenti euopian në Rezolutën e vitit 2007 (pika 16) mbi Marrëveshjen TRIPs përjashtoi mundësinë që Komisioni europian të negocionte marrëveshje *TRIPs Plus* me vendet në zhvillim në lidhje me produktet farmaceutike*.
- Po ashtu në Rezolutën e vitit 2012 (pika 13) mbi negocimet ACTA, Parlamenti europian përcaktoi se masat e ndërmarra për të përforcuar bashkëpunimin ndërkufitar nuk duhet të kushtëzojnë aksesin global në produkte farmaceutike të ligjshme, të leverdishme dhe të sigurta, përfshirë këtu edhe produktet e përgjithshme, me preteksin e luftës ndaj falsifikimit.*

*<http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//TEXT+TA+P6-TA-2007-0353+0+DOC+XML+Vo//EN>

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

- Aktualisht, ACTA lejon sekuestrimin e mallrave në tranzit mes kufijve nga ana e autoriteteve kufitare (pra pa ndërhyrjen e gjykatës) duke u bazuar vetëm në denoncimin e palëve që prezumohen si të dëmtuara*.
- Madje është e mundur edhe eliminimi i tyre patë dejtë dëmshpërbilimi. Psh. në vitin 2008-2009 dogana holandeze sekuestroi produkte farmaceutike të përgjithshme vetëm sepse etiketimi i tyre ishte i ngjashëm me atë të produkteve farmaceutike të markave të njohura pra të ngatërrueshme me këto të fundit.

*<http://brunosaetta.it/internet/acta-farmaci-generici-ed-importazione-parallela-di-medicinali.html>

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

Pi & shëndeti: produktet farmaceutike dhe ato ushqimore.*

-ACTA ndikon ndjeshëm në tregtinë e produkteve farmaceutike. Promovuesit e saj argumentojnë se ACTA ndihmon në luftën e tregtisë së produkteve farmaceutike të falsifikuara, pra potencialisht të dëmshëm për shëndetin.

-Në të kundërt, opozitorët e ACTA-s theksojnë se marrëveshja duke i dhënë përpaësi mbrojtjes së patentave, pengon importimin paralel (praktikë kjo që i lejohet vendeve në zhvillim).

-Kjo mund të sjellë si pasojë pakësimin e disponibilitetit të produkteve farmaceutike me cmime të aksesueshmenë zonat e varfra të botës.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

PI & E drejta për informacion

- Të informosh në kuptimin e etimologjik të fjalës do të thotë *të japësh formë*.
- Dallohen të dhënat (pra faktet) të cilat mund të shpërndahen pa iu bërë ndryshime nga të dhënat e ndryshuara, të komentuar apo të sistemuara.
- Informacioni nuk ekziston nëse nuk qarkullohen dhe ndahet nga të tjerë nëpërmjet shkëmbimit ai pasurohet.

Dr. Blendi Himci - U.A.Xhuvani

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

PI & E drejta për informacion

- E drejta për informacion nënkupton si *të drejtën për të informuar* ashtu edhe *të drejtën për t'u informuar*.
- Rregulli është akses në informacion, ndërsa kufizimi i saj përbën përjashtim.
- *Kjo nuk do të thotë se ky akses duhet të jetë falas*, por që të githëve duhet t'u jepet mundësia efektive për të marrë informacioni që korrespondon me nevojat vetjake dhe që t'u komunikojnë të tjerëve dijet e tyre.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

PI & E drejta për informacion

-E drejta e lirisë së informimit dhe e drejta për qasje të lirë në informacionet me karakter publik janë të lidhura ngushtë me lirinë e shprehjes ose me lirinë e të folurit.

-Neni 9 D.U.D.Nj. përcakton se “Çdokush ka të drejtën e lirisë së mendimit e të shprehjes.

-Kjo e drejtë përfshin edhe lirinë që të mbështetet një mendim i caktuar, të kërkohen, të merren e të jepen informacione e ide përmes mediave të ndryshme dhe pa përfillur kufijtë”.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

PI & E drejta për informacion

- Informacioni është element i kontrollimit të pushtetit publik dhe, duke u nisur nga kjo, publikimi i informacionit është me interes publik, për shkak se opinioni publik “KA TË DREJTË TË DIJË*”.

*Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, *Qasja në informacione me karakter publik është e lirë*, maj 2009, nw http://komspi.mk/Content_Data/Baneri/Qasja%2one%2oinformacione.pdf, fq. 5.

3. PI & Të drejtat e njeriut në aktet ndërkombëtare dhe ato europiane

PI & E drejta për informacion

- Në raport me të drejtën e autorit përjashtimet dhe kufizimet bëjnë të mundur gjetjen e një ekuilibri mes të drejtave ekskluzive të përdorimit ekonomik të veprës me të drejtën për informim.
- Megjithatë e drejta e *copyright* nuk mund të zbatohet në kundërshtim me të drejta të tjera themelore sic është liria e informimit dhe mbrojtja e *privacy*.
(shih vendimin Gj.E.D. në çështjen *Sabam-Scarlett*, C- 70/10 *).

*<http://www.futureofcopyright.com/home/blog-post/2011/11/24/ecj-scarlett-vs-sabam-general-monitoring-obligation-for-isps-is-not-compatible-with-eu-law.html>

Dr. Blendi Himci - U.A.Xhuvani

4. Praktika gjyqësore e GJED

Në çështjen *Scarlet c. Sabam*, shtrohen dy çështje kryesore përpara Gj.E.D:

- nëse duhet të lejohet t'iu ofrohen shoqërive të adminsitrimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të editorëve, të dhënat identifikuesve të përdoruesve të cilët prezumohet të kenë kyer shkelje, me qëllim identifikimin dhe ndjekjen e tyre;
- nëse është e ligjshme të detyrohen një *ISP (Intenet Service Provider)* që të *monitorojë aktivisht*, pra të *kontrollojë* paraprakisht, pa kriter dhe në mënyrë globale aktivitetin dhe trafikun e të dhënave që vijnë nga përdoruesit e tij (ISP), në mënyrë që të *filtrojnë*, *bllokojnë* dhe *heqin përmbajtjen* që përbën shkelje.

4. Praktika gjyqësore e GJED

Sipas argumentimit të Gj.E.D.,

vendimi i gjykatës belge shkel të dejtën komunitare duke mos garantuar një ekuilibër të dejtë mes të të drejtave PI, konkurrencës së lirë mes sipërmarrësve, mbrojtjes të të dhënave personale dhe liria për të shkëmbyer informacion në rrjet kur nuk egzistojnë ndalime të vlefshme (për të kyer këtë shkëmbim).

Në lidhje me nevojën e bilancimit të të drejtave themelore të pronësisë - pjesë e të cilave janë dhe të drejtat e PI - me të drejta të tjera themelore shih pikat 62-68 të vendimit dt. 29 janar 2008 të Gj.E.D. në çështjen C-275/06, *Promusicae*.

4. Praktika gjyqësore e GJED

Gj.E.D. e bazon vendimin e saj në parimin e *net neutrality* - i sanksionuar në nenin 15 Dir. 31/2000/KE, par. 1* dhe në parimin e *proporcionalitetit*, sipas të cilit:

shtetet, në transpozimin e direktivave, duhet t'i interpretojnë ato në mënyrë që të garantohet një ekuilibër i drejtë mes disa të drejtave themelore të mbrojtura nga rendi juridik komunitar.

* “Në ofrimin e shërbimeve të përmendura në nenet 12, 13 e 14, shtetet anëtare nuk detyrojnë ofruesit e shërbimeve një detyrim të përgjithshëm të monitorimit mbi informacionin që transmetojnë ose memorizojnë dhe as një detyrim të përgjithshëm që të kërkojnë në mënyrë aktive fakte apo rrethana që tregojnë egzistencën e aktiviteteve të palejueshme”.

4. Praktika gjyqësore e GJED

Kjo do të thotë se *e drejta e pronësisë intelektuale* edhe pse e përmendur në Kartën e të Drejtave Themelore (Karta e Nicës) në nenin 17 par. 2, nuk është *as e paprekshme dhe as absolute*.

Kjo e drejtë duhet bilancuar me të drejta dhe liri themelore sic janë: *e drejta e privatësisë dhe e sekretit në komunikim* (neni 7 Kartës së Nicës); *liria e informacionit* (neni 11.1. Kartës së Nicës) *dhe liria e sipërmarrjes**.

*http://www.comparazionedirittocivile.it/prova/files/oda_cdg.pdf

5. PI në të drejtën shqiptare

Neni 41 Kushtetutes shqiptare: 1.E drejta e pronës private është e garantuar.

- A mund të flitet në rastin e krijimtarisë intelektuale për pronësi?
- Cfare kuptojmë sot me termin “e drejtë e pronësisë”?
- Cilët janë kufijtë e pronësisë intelektuale?
- A mund të konsiderohet krijimtaria intelektuale si pronë private?
- Cila është kategoria e sendeve që mund të përbëjë pronë private?

5. PI në të drejtën shqiptare

Neni 58 Kushtetutesh shqiptare:

1. *“Liria e krijimit artistik dhe e kërkimit shkencor, vënia në përdorim si dhe përfitimi prej arritjeve të tyre janë të garantuara për të gjithë”.*
2. *“E drejta e autorit mbrohet me ligj”.*

-Cili është raporti mes lirive dhe të drejtave themelore dhe të drejtave të pronësisë intelektuale? Psh. me lirinë e shprehjes, së shtypit, të radios dhe televizionit; lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës; të drejtën e informimit; të drejtën për arsimim; të drejtën për sigurim shendetesoretj.

-Cilat janë liritë dhe të drejtat që mund të kufizohen (dhe nëse po deri në c’masë) nga mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale?

5. PI në të drejtën shqiptare

PI & E drejta për informacion

VKM Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor Nr.16, datë 4.1.2012

a) "Informacion mjedisor" ka kuptimin e referuar në ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 "Për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Aarhusit", sipas këtyre kategorive:

Dr. Blendi Himci - U.A.Xhuvani

5. PI në të drejtën shqiptare

PI & E drejta për informacion

VKM Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor Nr.16, datë 4.1.2012

Kategoria e parë përfshin:

- çdo material informues, që u referohet elementeve mjedisore të vendit, ku përfshihen të dhënat për ajrin e brendshëm dhe të jashtëm, atmosferën, ujin, tokën, peizazhin, zonat natyrore, burimet natyrore, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, diversitetin biologjik dhe përbërësit e tyre, organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe bashkëveprimi i të gjitha këtyre elementeve.

Dr. Blendi Himci - U.A.Xhuvani

5. PI në të drejtën shqiptare

PI & E drejta për informacion

VKM Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor Nr.16, datë 4.1.2012

Kategoria e dytë përfshin :

- faktorët natyrorë, substancat, energjia, zhurmat, radoni apo niveli i rrezatimit, si dhe aktivitetet ose masat e marra, përfshirë masat administrative, marrëveshjet në fushën e mjedisit, politikat, legjislacioni, planet dhe programet, që ndikojnë ose pritet të ndikojnë në elementet e mjedisit, të përfshira në kategorinë e parë, dhe përfitimet e analizat ekonomike si pasojë e vendimmarrjes mjedisore.

Dr. Blendi Himci - U.A.Xhuvani

5. PI në të drejtën shqiptare

PI & E drejta për informacion

VKM Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor Nr.16, datë 4.1.2012

Kategoria e tretë përfshin :

- të dhëna për sigurinë e shëndetit dhe kushteve të jetës së njerëzve, gjendjen aktuale të zonave kulturore dhe ndikimet e mundshme të faktorëve të kategorisë së dytë mbi këto zona.



Kontakt:

With the support of the
Erasmus+ Programme
of the European Union



Faleminderit për vëmendjen!

Pyetje?

Dr. Av. Blendi Himçi

Department of Law
Faculty of Economy
University of Elbasan

Blendi.himci@uniel.edu.al



Legjislacioni dhe institucionet e BE për profesionistët e së ardhmes - SHKOLLA VERORE

KATEDRA JEAN MONNET - EEAABAC - EU ENLARGEMENT and ACQUIS ADOPTION BURDEN: ALBANIAN CHALLENGES